



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E FINANCËS DHE PROJEKTEVE

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE NË ZBATIM TË CENS-IT TË POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Në zbatim të ligjit Nr 17/2018, datë 08.05.2018 “Për Statistikat Zyrtare “, Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Dokumentin e Srtategjisë dhe Planifikimit të CENS-it 2020, si dhe në Kontratën e Grantit direkt për projektin “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të CENS-it të Popullsisë dhe Banesave 2020” me Nr.1817Prot, datë 11.12.2018 lidhur ndërmjet Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e Bashkimit Evropian dhe Bankes Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU), Drejtoria e Financës dhe Projekteve pranë INSTAT, shpall procedurat e rekrutimit për vendet e lira si më poshtë vijon:

1. Koordinator Administrativ për CENS-in e popullsisë dhe Banesave 2020 (1 pozicion)

[Kriteret dhe Pershkrimi punës per pozicionin](#)

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për të gjithë aplikantët do të jetë data 11/03/2019.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a -Kërkesë për pozicionin
- b-Jetëshkrim i aplikantit (CV, sipas formatit të europass);
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda **datës 11/03/2019** pranë Drejtorisë të Financës dhe Projekteve ne INSTAT.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Kualifikime dhe Eksperienca

- Diplomë universitare në Shkencat Shoqërore.
- Eksperienca në fushën menaxhimit të projekteve dhe/ose fusha të ngjashme me të përbën avantazh.
- Të njohë shumë mirë programet kompjuterike dhe office (word, excel, powerpoint, MS Project)
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe angleze.

Aftësi të tjera

- Të jetë bashkëpunues;
- Të jetë i aftë të punojë në grup;
- Të jetë i aftë të kërkojë dhe të japë llogari;
- Të jetë i aftë të marrë vendime dhe të menaxhojë situata të paparashikuara;
- Të ketë aftësi të ndërtojë marrëdhënie efektive të punës me stafin e projektit dhe partnerët;
- Të jetë në gjendje të drejtojë dhe të forcojë tek bashkëpunëtorët kulturën e performacës kreative;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

Fusha e Njohurive

- VKM Nr.541 datë 18.6.2015 Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II (2014 – 2020)
- Marrëveshja kuadër IPA II 2014-2020
- Menaxhimi financiar i fondeve IPA sipas rregullave të PRAG
- Dokumenti i Strategjisë dhe Planifikimit të Censit 2020
- Rekomandimet e Cens 2020
- Ligji për Censin e Popullsisë dhe të Banesave
- Rregulloren e Eurostat: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1412688957286&uri=CELEX:32008R0763>

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Në datën **18/03/2019**, Drejtoria e Financës dhe Projekteve do të shpallë në faqen e internetit të Institutit të Statistikave listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e rekrutimit, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista/testim/konkurs.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Financës dhe Projekteve në Institutin e Statistikave, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042233356, ose në adresën: Instituti i Statistikave, “Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017Tiranë, SHQIPËRI”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al